

A\BANIK

A. NDIHMË NGA NJË AVOKAT. E DREJTA PËR KËSHILLA LIGJORE

Keni të drejtë të komunikoni në mënyrë konfidenciale me një avokat. Avokati është i pavarur si nga policia ashtu dhe nga organet gjyqësore, të cilat, ashtu si dhe policia, duhet t'ju ndihmojnë të kontaktoni me një avokat, nëse e kërkon. Në raste të caktuara ndihma jepet falas.

B. INFORMIM NË LIDHJE ME AKUZËN PENALE. Keni të drejtë të informoheni për arsyen e arrestit dhe të burgosjes tuaj, gjithashtu edhe për veprën, për të cilin akuzoheni se keni kryer.

C. PËRKTHIMI. Nqs nuk e flisni ose nuk kuptoni gjuhën e policisë ose të organeve të tjera kompetente, keni të drejtë të kërkonit ndihmën e një përkthyesi falas. Përkthyesi mund t'ju ndihmojë të flisni me avokatin tuaj dhe është i detyruar të mbajë sekret përmbajtjen e bisedës tuaj me avokatin. Keni të drejtë të kërkonit t'ju përkthehen të paktën disa fragmente të dokumenteve kryesore, duke përfshirë çdo urdhër gjyqësor për arrestimin ose burgimin tuaj, çdo akuzë ose aktakuzë dhe çdo vendim tjetër. Në raste të caktuara mund t'ju ofrohet përkthim me gojë ose një përmbledhje .

D. E DREJTA E HESHTJES. Gjatë marrjes tuaj në pyetje nga policia ose nga organe të tjera kompetente nuk jeni i detyruar t'u përgjigjeni pyetjeve për krim që mund të keni kryer. Avokati juaj mund t'ju ndihmojë të vendosni për këtë çështje.

E. AKSES NË DOKUMENTACION. Gjatë arrestimit dhe burgimit tuaj, ju (ose avokati juaj), keni të drejtën e aksesit në dokumentacionin kryesor që ju nevojiten për tu ankuar kundër arrestit ose burgimit. Nqs çështja juaj kalon në gjykatë, ju (ose avokati juaj) keni të drejtë të keni akses në provat materiale që mund të jenë në favorin tuaj ose kundër jush.

F. LAJMËRIM I PERSONAVE TË TRETË PËR ARRESTIMIN OSE BURGIMIN TUAJ / NJOFTIM I AMBASADËS OSE KONSULLATËS TË VENDIT TUAJ. Gjatë arrestimit ose burgimit tuaj, duhet të informoni policinë nëse dëshironi të njoftoni ndonjë person për burgimin tuaj p.sh. një pjesëtar të familjes tuaj ose punëdhënësin tuaj. Në raste të caktuara e drejta për të lajmëruar persona të tjerë për burgimin tuaj mund të kufizohet përkohësisht. Në këtë rast organet policore do t'ju njoftojnë. Nëse jeni i huaj, informoni organet policore nqs doni të njoftoni për arrestin tuaj zyrën konsullore ose ambasadën e shtetit tuaj. Gjithashtu ju lutemi të njoftoni organet policore, nëse dëshironi të kontaktoni me një nëpunës të zyrës konsullore ose të ambasadës së shtetit tuaj.

G. KUJDES SHËNDETËSOR URGJENT. Gjatë arrestimit ose burgosjes tuaj keni të drejtë të keni shërbim shëndetësor në rast problemi urgjent. Ju lutemi të njoftoni organet policore, nëse keni një problem urgjent dhe nevojë për kujdes shëndetësor.

H. KOHËZGJATJA E HEQJES SË LIRISË. Pas arrestimit tuaj ka mundësi t'ju hiqet liria ose të mbaheni të burgosur për 6 deri në 18 muaj maksimumi. Pas përfundimit të këtij afati kohor, ju duhet të liheni të lirë.

Kundër mandatarrestit për burgim të përkohshëm dhe urdhrit të hetuesit që vendosi

kufizimin e lirisë, i akuzuari mund të ushtrojë ankim në këshillin e Gjykatës Penale. Ankimi bëhet brenda 5 ditëve nga dita e burgosjes së përkohshme. Hartohet raport nga sekretari i Gjykatës Penale ose nga drejtori i burgut, siç parashikohet në nenin 474 par.1. Ankimi i transmetohet prokurorit të Gjykatës Penale dhe dërgohet pa vonesë bashkë me propozimin e tij në Këshill, i cili merr vendim të formës së prerë. Personi i burgosur përkohësisht ose ai të cilit i janë vendosur masa kufizuese mund të bëjë kërkesë drejtuar hetuesit për heqjen e këtyre masave ose për zëvendësim të masës së arrestit të përkohshëm me masa kufizuese ose për zëvendësimin e masave kufizuese me të tjera. Kundër urdhrit të hetuesit mund të ushtrohet ankim në Këshill brenda afatit 5 ditor nga dita që ankimesit i është njoftuar urdhri i hetuesit.

Μαρινελα Χαντζαρα

. Δικηγόρος Θεσσαλονίκης